

LIGJ
Nr.8291, datë 25.2.1998
KODI I ETIKËS SË POLICISË
(Ndryshuar me ligjin nr. 8898, datë 16.5.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kodi i Etikës së Policisë është tërësia e parimeve dhe normave, mbi bazën e të cilave punonjësit e të gjitha llojeve të policisë në Republikën e Shqipërisë shprehin vullnetin e tyre dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe zbatimin e ligjit, duke u karakterizuar nga humanizmi, objektiviteti dhe sjellja e kulturuar gjatë përmbushjes së detyrave.

Neni 2

Policia është në shërbim të publikut për ruajtjen e rendit e të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, të qetësisë publike dhe mbrojtjen e lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Neni 3

Gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara me ligj, punonjësit e policisë veprojnë me ndershmëri dhe paanësi, duke kërkuar zbatimin e njëjtë të ligjit nga individët, pavarësisht nga bindjet politike a fetare, raca, pozita shoqërore dhe shtetërore, kombësia e shtetësia ose kushtet ekonomike që ata kanë.

Neni 4

Punonjësit e policisë detyrohet ta mbajnë uniformën në rregull, në të cilën të dallohen qartë shenjat e veçanta personale dhe të shërbimit, si dhe gradat.

Neni 5

Punonjësit e policisë luftojnë me vendosmëri ndaj korrupsionit dhe abuzimeve në detyrat shtetërore që kryejnë, si dhe detyrohen të denoncojnë tek eprorët e organeve kompetente çdo akt të çfaqjes së tyre.

Neni 6

Kur punonjësit e policisë vërejnë shkelje të ligjit, ndërmarrin dhe kryejnë të gjitha veprimet ligjore për kapjen e autorëve të veprave penale, rivendosjen e rendit e të qetësisë publike dhe për dhënien e ndihmës publikut.

Gjatë shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave të implikuar në krime, punonjësit e policisë zbatojnë me rreptësi normat ligjore, si dhe u ndalohet çdo akt torture a veprim tjetër që cenon personalitetin dhe dinjitetin e tyre.

Neni 7

Gjatë përmbushjes së detyrave të ngarkuar, punonjësit e policisë detyrohen t'i paraqiten publikut me gradën, detyrën që ata kanë, si dhe të tregojnë shkakun për të cilin ndërhyjnë. Veprimet e tyre duhet të jenë me takt, pa shqetësuar publikun përreth.

Neni 8

Punonjësit e policisë përgjigjen penalisht, administrativisht, civilisht dhe sipas rregullores së disiplinës për veprimet dhe mosveprimet e kryera me iniciativë ose në kundërshtim me urdhrin, si dhe për zbatimin e urdhrave të dhënë jo në formën e kërkuar nga ligji a rregullorja ose nga një person a organ jokompetent.

Punonjësi i policisë mban përgjegjësi për zbatimin e urdhrave haptazi të kundërligjshme. Kur urdhri i dhënë formalisht në përputhje me rregullat është i kundërligjshëm, punonjësi i policisë mban përgjegjësi në rast se para kryerjes së veprimit kishte mundësi të vinte në dijeni organet eprore ose menjëherë mbas zbatimit nuk i ka njoftuar ato për veprimin e kryer.

Neni 9

Punonjësit e policisë, gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duhet të tregojnë gatishmëri dhe vendosmëri për arritjen e qëllimit të përcaktuar.

Neni 10

Punonjësit e policisë nuk përdorin asnjëherë forcën në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Ata marrin dhe japin udhëzime të qarta e të përpikta për mënyrën dhe rrethanat kur përdoren forca dhe armët.

Neni 11

Punonjësi i policisë duhet të ruajë sekretin e të gjitha detyrave që kryehen. Ata lejohen të deklarojnë pjesë të sekretit të detyrave që kryejnë vetëm kur udhërohen ose autorizohen me shkrim nga një autoritet epror dhe kompetent i parashikuar në ligj.

Neni 12

Kur një punonjësi të policisë i kërkohet të mbushë një urdhër a një detyrë që është në kundërshtim të hapur me ligjin, ai është i detyruar ta refuzojë zbatimin e tij dhe të informojë eprorin më të lartë.

Neni 13

Marrëdhëniet ndërmjet punonjësve të policisë bazohen në rregulloren hierarkike e në respektin e ndërsjellë, si dhe në ruajtjen e personalitetit të punonjësit.

Neni 14

Çdo mosmarrëveshje për masën disiplinore të dhënë ndaj një punonjësi të policisë, shqyrtohet me kërkesën e tij nga një komision disiplinor i ngritur në organin ose repartin ku ai është efektiv.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15

Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për zbatim në çdo situatë.

Neni 16

Dispozitat e këtij Kodi, si dhe legjislacioni në fuqi që lidhet me funksionimin e policisë, janë të detyrueshme për t'u përvetësuar dhe asimiluar në të gjitha format e përgatitjes teknike e profesionale të policisë shqiptare.

Çdo punonjës që fillon punë në radhët e policisë, nënshkruan një deklartë, me anën e së cilës ai shprehet i një mendimi me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 16/1

(Shtuar me ligjin nr. 8898, datë 16.5.2002)

Ngarkohet Ministri i Rendit Publik të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 6, 7, 8, 10 dhe 11 të këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.2003, datë 27.2. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**